



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ALEKANDËR MOISIU" Durrës
SENATI AKADEMIK

Nr. 539/4 Prot.

Durrës, më 10 . 02 2025

VENDIM

Nr. 9 , datë 10.02 . 2025

PËR

"MIRATIMIN E KUOTAVE TË PRANIMIT TË STUDENTËVE PËR CIKLIN E PARË TË STUDIMEVE BACHELOR, PROGRAMET E STUDIMIT ME KARAKTER PROFESIONAL 2-VJEÇAR, PROGRAM I INTEGRUAR I STUDIMEVE, CIKLIN E DYTË TË STUDIMEVE MASTER I SHKENCAVE DHE MASTER PROFESIONAL, PËR VITIN AKADEMIK 2025 – 2026, NË UNIVERSITETIN "ALEKSANDËR MOISIU", Durrës".

Në mbështetje të Ligjit Nr. 80/2015 "Për Arsimin e Lartë në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë"; Vendimin Nr. 436, datë 03.06.2020, të Këshillit të Ministrave, "Për përcaktimin e kriterit të notës mesatare për pranimin e kandidatëve në programet e studimeve të ciklit të parë dhe në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë ose transferimin e studimeve në vitet e ndërmjetme të këtyre programeve, në institucionet e arsimit të lartë, për vitet akademike 2020–2021 dhe 2021-2022 e në vijim", i ndryshuar, si dhe në shkresën e Drejtorisë së Kurrikulave Cilësisë dhe Statistikave me Nr. 462 Prot, datë 04.02.2025, në mbledhjen e datës 10.02.2025, Senati Akademik,

VENDOSI:

1. Miratimin e kuotave të pranimin të studentëve për ciklin e parë të studimeve Bachelor, Programet e Studimit me Karakter Profesional 2-vjeçar, Program i Integruar i Studimeve, ciklin e dytë të studimeve Master i Shkencave dhe Master Profesional, për vitin akademik 2025-2026, në Universitetin "Aleksandër Moisiu", Durrës, sipas materialit bashkëlidhur.
2. Për ndjekjen e zbatimin e këtij vendimi ngarkohen:
 - Zv. Rektorët,
 - Drejtuesit e Njësive Kryesore,
 - Drejtoria e Kurrikulave, Cilësisë dhe Statistikave.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR

Prof. Dr. Shkëlqim FORTUZI

